

AKTI I THEMELIMIT

DHE

STATUTI

I

SHOQËRISË

“New Moon Services” SH.P.K

TIRANË / SHQIPËRI

**AKT – THEMELIMI
I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TËKUFIZUAR**

“New Moon Services” sh.p.k.

Ortaku i Shoqërisë “**New Moon Services**” sh.p.k Z. Dragisa Barovic, i biri i Savo dhe Desanka , lindur më datë 25/07/1952, në Podgorice, Mal i Zi dhe me shtetësi Malazeze, e identifikuar me nr pasaporte B81HZ8288 dhe nr personal 2507952500559 sot, më datë 10/02/2021.

VENDOSI

Neni 1

Të themeloi një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar të quajtur: “**New Moon Services**” sh.p.k Shoqëria është një subjekt juridik shqiptar, të cilës i lind e drejtë të ushtrojë aktivitetin që nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të Biznesit (**QKB**).

Shoqëria “**New Moon Services**” sh.p.k zhvillon aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe me aktet e themelimit të saj.

Neni 2

Shoqëria do të jetë e formës së Shoqërive Tregtare me Përgjegjësi të kufizuar dhe përballon humbjet deri në kufirin e vlerës së derdhur në kapitalin themeltar.

Neni 3

“**New Moon Services**” sh.p.k ka selinë e saj në: Rr “Milto Tutulani” P.8/1, Tirane Shoqëria ka të drejtë të krijojë brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, filiale, agjensi përfaqësimi, seli sekondare, degë, si dhe ti suprimojë ato.

Shoqëria ka gjithashtu të drejtë të krijojë, apo të jetë pjesë e një apo më shumë shoqërive tregtare, pavarësisht nga statusi i tyre juridik, me një pjesëmarrje që do të përcaktohet në çdo rast me Vendim Ortaku.

Neni 4

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë do të jetë **pa afat**. Ajo mund të shpërbehet në çdo kohë në përputhje me dispozitat statutore dhe legjislacionin në fuqi.

Neni 5

Kapitali fillestar themelor i Shoqërisë “**New Moon Services**” sh.p.k do të jetë 10,000 (dhjete mijë) lekë, me kontributet te ortakut si me poshte

Emri Mbiemri	Përqindja	Kuota	Kontributi në
Z. Dragisa Barovic	100%	1	10,000 Lekë

Neni 6

Kapitali themeltar është tërësisht në para. Të gjitha kuotat e kapitalit themeltar janë tërësisht të derdhura dhe të nënshkruara nga ortaku themelues. Rritja e kapitalit të shoqërisë nuk është e kufizuar.

Neni 7

Objekti i aktivitetit ekonomik të shoqërisë do të jetë:

Sherbime dhe konsulencë Marketingu digital online. Sherbime dhe konsulencë marketingu te gjithe formave te ndryshme te mediave sociale Sherbime dhe konsulencë marketingu per ndertimin e faqeve Web, dhe realizimin e fushatave reklamuese onsite dhe online.Konsulencë per krijim, dhe mirembajtje te strategjive te marketingut per pale te treta duke perfituar nga promovimi i produkteve/aktivitetve te ndryshme ne baze te perqindrjes se shitjeve. Sherbime dhe konsulencë per SEM- Search Engine Marketing, duke perfshire promovimin e faqeve te internetit dhe rritur shikueshmerine e tyre ne faqet e rezultateve te motoreve te kerkimit. Pregatitjen dhe interpretimin e analizave te biznesit dhe raporteve statistikore. Sherbim dhe konsulencë ne optimizimin e SEO-Motoreve te kerkimit, me praktiken e rritjes se sasisë dhe cilesise së trafikut në faqen e internetit permes rezultateve organike te motoreve te kerkimit.

Për realizimin e qëllimit të mësipërm shoqëria ka të drejtë:

- t'ju besojë të tretëve pjesë të punimeve të produkteve të saj ose shërbimeve;

- të përfundojë kontrata agjensie me ose pa përfaqësim, me qëllim që të promovojë për llogari të palës tjetër ose të promovohet nga pala tjetër për llogari të saj, aktivitetet dhe prodhimet e mësipërme, duke përfshirë të gjitha aktivitetet e ndërmjetësimit të çfarëdo fushe;
- të operojë si në territorin kombëtar dhe jashtë tij.

Shoqëria mundet gjithashtu të realizojë të gjitha operacionet industriale, tregtare, mobiliare, imobiliare dhe financiare që do të konsiderohen nga ortakët apo nga organi Administrativ të nevojshme ose të dobishme për arritjen e objektivit të shoqërisë, përfshirë këtu lëshimin e fidejusioneve dhe garancive të tjera reale ose personale si në favor dhe për llogari të të tretëve edhe me titull të garantuar.

Shoqëria mundet gjithashtu të realizojë të gjitha operacionet e ndërmjetësimit industrial, tregtar, mobiliar, imobiliar dhe financiar që do të konsiderohen të nevojshme dhe/ose të dobishme nga ortakët për arritjen e objektivit të shoqërisë, përfshirë këtu lëshimin e fidejusioneve dhe garancive të tjera reale ose personale si në favor dhe për llogari të të tretëve edhe me titull të garantuar. Shoqëria mund të blejë lirisht kuota apo aksione të shoqërise të tjera, vendase dhe të huaja.

Neni 8

Shoqëria vepron nënregjimin e pronës private dhe merr përsipër të drejta e detyrime vetëm brenda kufirit të kapitalit të saj. Ortaku themelues mbart rrezikun e veprimtarisë së Shoqërisë në masën e kapitalit të investuar në Shoqëri.

Neni 9

Organet e shoqërisë “**New Moon Services**” sh.p.k janë:

- Ortaku i Vetem i Shoqerise
- Administratori i shoqërisë.

Modalitetet e formimit dhe funksionimit të tyre do të përcaktohen në statutin e shoqërisë.

Administrator i shoqërisë do të jetë **Z. Etien Raca**, i biri i Agim dhe Kaljana lindur më datë 12/01/1988, në Delvine, Shqiperi dhe me shtetësi Shqiptare, e identifikuar me nr identifikimi 034085035 dhe nr personal I80112081F, e cili do të ushtrojë dhe mbajë në mënyrë të veçantë kompetencat e administratorit, për një periudhë prej 5 (pese) vjet. Ky afat mund të ndryshojë lirisht në çdo moment që konsiderohet e nevojshme nga asambleja e ortakëve.

Përveç sa është përcaktuar shprehimisht në statutin dhe aktin e themelimit të shoqërisë, vetem administratori do të ketë tagra të kryejë veprime bankare në llogarinë e shoqërisë që lidhen me tērheqjen e shumave të depozituara apo çdo veprim tjetër, veprime të cilat mund të kryhen vetëm nga administratori apo person të tjerë të autorizuar enkas me prokurë të posaçme për këtë qëllim.

Modalitetet për ndryshimin e administratorit si dhe kompetencat e tij rregullohen nga Statuti i shoqërisë, ligji 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” si dhe ligji Nr. 9723 datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Ky Akt – Themelimi është përpiluar në katër kopje me vlerë të njëjtë me originalin.

ORTAKU I VETEM I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR


“New Moon Services” shpk

Z. Dragisa BAROVIC

Tiranë, me 10/02/2021

Perfaqesuar me prokure nga;

Arlinda Marku



A handwritten signature in black ink, appearing to read "Arlinda Marku". Below the signature is a stylized, handwritten signature that looks like a stylized 'A' or 'M'.

STATUT
I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“New Moon Services” sh.p.k..

Në këtë statut:

- “Ligji” është Ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”;
- “Statuti” është Statuti i shoqërisë;

Kreu I
Themelimi, Emri, Objekti, Selia

Neni 1: Data e Themelimit, Emri dhe themeluesit

Sot, më datë 10/02/2021, është themeluar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e emërtuar **“New Moon Services” sh.p.k.** me adresë: Rr “Milto Tutulani” P.8/1, Tirane.

Themelues dhe ortak i shoqërisë eshte:

Z. Dragisa Barovic, i biri i Savo dhe Desanka , më datë 25/07/1952, në Podgorice, Mal i Zi dhe me shtetësi Malazeze, e identifikuar me nr pashaporte B81HZ8288 dhe nr personal 2507952500559

Neni 2: Objekti

Sherbime dhe konsulencë Marketingu digital online. Sherbime dhe konsulencë marketingu te gjithe formave te ndryshme te mediave sociale Sherbime dhe konsulencë marketingu per ndertimin e faqeve Web, dhe realizimin e fushatave reklamuese onsite dhe online.Konsulencë per krijim, dhe mirembajtje te strategjive te marketingut per pale te treta duke perfituar nga promovimi i produkteve/aktivitetve te ndryshme ne baze te perqindrjes se shitjeve. Sherbime dhe konsulencë per SEM- Search Engine Marketing, duke perfshire promovimin e faqeve te internetit dhe rritur shikuesherine e tyre ne faqet e rezultateve te motoreve te kerkimit. Pregatitjen dhe interpretimin e analizave te biznesit dhe raporteve statistikore. Sherbim dhe konsulencë ne optimizimin e SEO-Motereve te kerkimit, me praktiken e rritjes se sasise dhe cilesise së trafikut në faqen e internetit permes rezultateve organike te motoreve te kerkimit.

Për realizimin e qëllimit të mësipërm shoqëria ka të drejtë:

- t’ju besojë të tretëve pjesë të punimeve të produkteve të saj ose shërbimeve;
- të përfundojë kontrata agjensie me ose pa përfaqësim, me qëllim që të promovojë për llogari të palës tjetër ose të promovohet nga pala tjetër për llogari të saj, aktivitetet dhe prodhimet e mësipërme, duke përfshirë të gjitha aktivitetet e ndërmjetësimit të çfarëdo fushe;
- të operojë si në territorin kombëtar dhe jashtë tij.

Shoqëria mundet gjithashtu të realizojë të gjitha operacionet industriale, tregtare, mobiliare, imobiliare dhe financiare që do të konsiderohen nga ortaku apo nga organi Administrativ të nevojshme ose të dobishme për arritjen e objektivit të shoqërisë, përfshirë këtu lëshimin e fidejusioneve dhe garancive të tjera reale ose personale si në favor dhe për llogari të të tretëve edhe me titull të garantuar.

Shoqëria mundet gjithashtu të realizojë të gjitha operacionet e ndërmjetësimit industrial, tregtar, mobiliar, imobiliar dhe financiar që do të konsiderohen të nevojshme dhe/ose të dobishme nga ortakët për arritjen e objektivit të shoqërisë, përfshirë këtu lëshimin e fidejusioneve dhe garancive të tjera reale ose personale si në favor dhe për llogari të të tretëve edhe me titull të garantuar. Shoqëria mund të blejë lirisht kuota apo aksione të shoqërive të tjera, vendase dhe të huaja.

Neni 3: Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë do të jetë **pa afat**. Ajo mund të shpërbëhet në çdo kohë në përputhje me dispozitat statutore dhe legjislacionin nëfuqi. Ky afat mund të kufizohet me vendim asambleje.

Neni 4: Selia

-Shoqëria ka selinë ligjore në adresën: Rr “Milto Tutulani” P.8/1, Tirane.

-Transferimi i selisë brenda të njëjtës Bashki, apo dhe në Bashki të tjeter, mund të vendoset nga organi administrativ dhe nuk do të sjellë modifikimin e statutit.

Kreu II

Kapitali themeltar

Neni 5: Kapitali themeltar

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është **10,000 (dhjete mijë) lekë** dhe është i ndarë në kuota në kuptim të Ligjit. Pjesëmarrja e themeluesit në kapitalin themeltar të shoqërisë është në masën 1kuote.

Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

Neni 6) Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

6.1 Zmadhimi i kapitalit

- Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë ose kredi.
- Administratorit nuk i jepet e drejta të zmadhojë kapitalin, e drejtë kjo që disponohet vetëm nga ortakët.

6.2 Zvogëlimi i kapitalit.

- Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim me të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Administratorit nuk i jepet e drejta të zvogëlojë kapitalin, si dhe të kryejë veprime bankare pa një autorizim të asamblesë së ortakëve, i cili do të jepet me Vendim Asambleje, në format e kërkuara nga ligji.

Neni 7) Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) Kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) Shitblerjes;
- c) Trashëgimisë;
- d) Dhurimit;
- e) Çdo mënyre tjeter të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Kreu III

ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE

Neni 8: Organi vendimmarrës

8.1– Ortaku është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Ortaku është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj. Ortaku mund të marre vendime pranë selisë së shoqërisë ose në tjetër vend, me kusht që ky të ndodhet brenda territorit Shqiptar.

Ortaku është përgjegjës për marrjen e vendimeve për shoqerinë për çështjet e mëposhtme:

- 1) ndryshimet e statutit;
- 2) emërimin e shkarkimin e administratorit/administratorëve;
- 3) autorizimin e administratorit për kryerjen e veprimeve me bankat, autorizim i cili do të jepet rast pas rasti për kryerjen e veprimeve të caktuara;
- 4) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- 5) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur nëpikat “3” dhe “4” të pikës 8.1 të këtij nenit;
- 6) Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- 7) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- 8) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- 9) Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- 10) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- 11) Riorganizimin e prishjen e shoqërisë;
- 12) Miratimin e rregullave proceduriale të mbledhjeve të asamblesë;
- 13) Çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Neni 9: Marrja e vendimeve

Ortaku vendos për ndryshimin e statutit, zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Ortaku vendos për çështje të tjera si:

1. përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
2. emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
3. emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
4. përcaktimin e shpërblimeve;
5. mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
6. përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe nëprocedime të tjera ndaj administratorëve;
7. miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë.

Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Neni 10: Administrimi

Ortaku emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit është pesë vjet, me të drejtë ripërtëritje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).

Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas parashikimeve të nenit 207 të Ligjit, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

Personi i mëposhtëm caktohet si administrator i parë i shoqërisë.

Z. Etien Raca, i biri i Agim dhe Kaljana lindur më datë 12/01/1988, në Delvine, Shqiperi dhe me shtetësi Shqiptare, e identifikuar me nr identifikimi 034085035 dhe nr personal I80112081F, i cili do të ushtrojë dhe mbajë në mënyrë të veçantë kompetencat e administratorit, për një periudhë prej 5 (pese) vjetesh. Ky afat mund të ndryshojë lirisht në çdo moment që konsiderohet e nevojshme nga ortaku.

Pushimi administratorëve për arsyet e mbarimit të afatit të emërimit, ka efekt nga momenti në të cilin emërohet organi i administrimit pasues.

Neni 11: Kompetencat e Administratorëve

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- 1) Kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;

- 2) Përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- 3) Kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- 4) Përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme të ortakëve për miratim;
- 5) Krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- 6) Kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- 7) Raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- 8) Kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në këtë statut.

Administratorët janë të detyruar të kerkojne Vendim nga Ortaku kur:

- Sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- Shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, kuota të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5% të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- Nëse Ortaku emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë, alternativisht, me përashtim të rasteve kur asambleja e ortakëve merr vendim ndryshe.

Përveç sa është përcaktuar shprehimisht në statutin dhe aktin e themelimit të shoqërisë, Administratori do të ketë tagra të kryejë veprime bankare në llogarinë e shoqërisë që lidhen me térheqjen e shumave të depozitura apo çdo veprim tjetër, veprime të cilat mund të kryhen vetëm nga administratori apo persona të tjerë të autorizuar enkas me prokurë të posaçme për këtë qëllim nga Ortaku.

Ortaku mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë më shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Kreu IV Viti finanziar

Neni 12: Viti Financiar

Viti finanziar i Shoqërisë fillon me 1 janar dhe përfundon me 31 dhjetor. Përashtimisht viti i parë finanziar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbylljet me 31 dhjetor.

Kreu V Prishja-riorganizimi i shoqërisë

Neni 13: Prishja dhe likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- a) Kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelin e saj;
- b) Me vendim të Ortakut
- c) Me hapjen e procedurave të falimentimit;

d) Nëse nuk ka kryer veprimitari tregtare për dy vjet dhe nuk është njofuar pezullimi i veprimitarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;

e) Me vendim të gjykatës;

f) Në këtë rast Ortaku merr vendim me shkrim në të cilën parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë “Shoqëri në likuidim e sipër”. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaku. Nëse ortaku nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund ti drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 14: Riorganizimi i shoqërisë, bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit te Ortakut në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Neni 15: Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet me këtë statut do të zbatohen dispozitat e ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjeter specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 16: Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare dhe më konkretisht Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 17: Klauzola të kompromisit

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund te lindin ndërmjet ortakut dhe shoqërisë, në lidhje me raportet shoqërore ose për interpretimin e zbatimin e këtij statuti dhe të vendimeve ligjërisht të nxjerra nga organet e shoqërisë, ato të emëruara nga administratorët, likuidatorët dhe titullarët ose në raportet me ta, për sa janë shtruar për kompromis, do ti paraqiten Gjykatës nëRrethin në të cilin shoqëria ka selinë.

Neni 18: Referimet

Për sa nuk është shprehimisht përcaktuar në këtë statut, vlejnë dispozitat e ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare” dhe të ligjeve apo akteve nënligjore të posaçme të fushës.

ORTAKU I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“New Moon Services” shpk

Z. Dragisa BAROVIC
Perfaqesuar me prokure nga;
Arlinda Marku

Tirane, me 10/02/2021

ADMINISTRATORI
Z. Etien Raca

Arlinda Barovic
Etien Raca

H